

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik
ADRESA	https://dosja.al/ekonomi/shqetesimet-e-bankave-rritet-perceptimi-i-rrezikut-nga-tregu-i-pronave-d-i515929
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 05:49:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 05:37:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	142b5c131cee0afc9ccd4cf39479e7c3d7d0bf36c3580c6efd5b6699dc78d5f2
TEKSTI	00f71db9f6dee42183eb2c72bd55c3fd6c7ad4832a098a559c6a58cca677b37d
PAMJA	a467355ea635158729870ac32abf5081490eba2b8ed2f9adbbe4b11ca5f5e9c1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f0627afcd9714d5841e40d080b8cce2192753e8326d82bf5c8d8f7aa6c9b7133
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b78e5a58bb99b6139c75653f203f708926b237e838138b6b7709d24a7b49499b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f0627afcd9714d5841e40d080b8cce2192753e8326d82bf5c8d8f7aa6c9b7133>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

8 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salle në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranian. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtra të pabaza

13 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

16 ORE ME PARE

Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

16 ORE ME PARE

Skandali SHISH/ Vlora Hyseni vë në rrezik vendin për Ergys Agasin: Të gjithë radarët e shtetit i mbyll për ty

Ekonomi

Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik

Transferimi i goditjeve nga ekonomia e jashtme vijon të konsiderohet si rreziku sistemik më i rëndësishëm nga bankat. Pas një zbutjeje të përkohshme në gjysmën e dytë të vitit 2025, vlerësimi për këtë rrezik është rritur përsëri gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 nga niveli "mesatar" në "i lartë".



25 Shtator 2026, 07:37
Nga E. D



TIRANË- Rezultatet e vërtetimit mbi perceptimin e rreziqeve sistematike në vend nga sektori bankar tregojnë se, gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, renditja e rreziqeve kryesore dhe nivelet e perceptimit të tyre kanë paraqitur ndryshime, me rritje të shqetësimit të lidhur me çmimet e pronave dhe të atij politik, pas valës disamujore të protestave ndaj qeverisë.

Transferimi i goditjeve nga ekonomia e jashtme vijon të konsiderohet si rreziku sistemik më i rëndësishëm nga bankat. Pas një zbutjeje të përkohshme në gjysmën e dytë të vitit 2025, vlerësimi për këtë rrezik është rritur përsëri gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 nga niveli "mesatar" në "i lartë".

Kjo ecure ka reflektuar pasiguritë e vazhdueshme në mjedisin ekonomik dhe gjeopolitik ndërkombëtar dhe potencialin e tyre për t'u transmetuar në ekonominë shqiptare.

Rreziku i lidhur me luhajtjen e vlerës së pasurive të paluajtshme është klasifikuar si rreziku i dytë më i rëndësishëm sistemik i periudhës dhe vlerësimi për të është rritur duke kaluar nga niveli "i ulët", në "mesatar".

Rritja e vazhdueshme e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe ekspozimi i konsiderueshëm i sektorit bankar ndaj këtij tregu vazhdon të mbajë këtë rrezik në grupin e faktorëve që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm.

Megjithatë intensiteti i perceptuar nga bankat nuk është i lartë, shqetësimi i tyre është në rritje, veçanërisht për ndikimin e mundshëm të një korrigjimi të çmimeve në vlerën e kolateralit dhe rrezikun e kredisë.

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se
ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje



BOTA 24 SHTATOR 2026, 22:20

VIDEO/ Netanyahu ironizon delegatët që braktisën sallën gjatë fjalimit në OKB: Ikni frikacakë!

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 21:50

Sulmi i Hysenit ndaj gazetares/ Lala: Zgjedhi njeriun e gabuar, nuk kam asgjë për të fshehur opinionin shqiptar

Përkeqësimi i ekonomisë së brendshme vijon të mbetet në grupin e rreziqeve më të rëndësishme sistemike në vend. Në perceptimin e bankave, vlerësimi për këtë rrezik është zbutur krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2025, por duke mbetur brenda nivelit “mesatar”.

Rreziku nga sulmet kibernetike vijon të perceptohet si një nga rreziqet kryesore sistemike. Megjithatë, vlerësimi i sektorit bankar për rëndësinë e tij ka rënë gjatë gjysmës së parë të vitit 2026 krahasuar me dy periudhat paraardhëse, gjë që mund të lidhet me investimet dhe strategjitë e ndërmarra nga bankat për të kufizuar këtë rrezik.

Pavarësisht kësaj, në kushtet e digjitalizimit gjithmonë e më të madh të shërbimeve financiare dhe kompleksitetit në rritje të kërcënimeve kibernetike, ky rrezik është bërë tashmë një nga sfidat kryesore të biznesit bankar.

Së fundi, perceptimi mbi rrezikun politik ka shënuar rritje krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2025, duke u përfshirë në listën e rreziqeve kryesore sistemike.

Rritja e këtij perceptimi mund të lidhet me shtimin e pasigurive rreth zhvillimeve politike dhe institucionale në vend, të cilat mund të ndikojnë në pritjet e agentëve ekonomikë dhe në klimën e biznesit.

Megjithatë, në vlerësimin e bankave, rëndësia e këtij rreziku vlerësohet ende ndjeshëm më e ulët krahasuar me rreziqet e tjera të lartpërmendura.

Në terma të përgjithshëm, deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2026, bankat vlerësojnë se mundësia e materializimit të një ose disa prej rreziqeve sistemike në horizontin afatshkurtër (deri në një vit) mbetet nën nivelin mesatar, megjithëse ky perceptim është rritur lehtë krahasuar me gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025.

Për horizontin afatmesëm (1–3 vjet), perceptimi i bankave për materializimin e këtyre rreziqeve mbetet më i lartë se ai afatshkurtër dhe ka shënuar gjithashtu rritje gjatë periudhës.

Nga ana tjetër, gjendja e mirë financiare e sektorit bankar dhe niveli i lartë i likuiditetit vijnë të mbështesin besimin e bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar, i cili mbetet mbi nivelin mesatar dhe pothuajse i pandryshuar krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar./Monitor

Sondazh

Poll

Ekonomi

25 Shtator 2026, 07:34

Paratë në bankë kanë ende gjini; Gratë vetëm 44% e depozituesve

foto ilustruese TIRANË- Numri i shqiptarëve që rezultojnë depozitues në banka është rritur gjatë viteve të fun...

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 21:04

“Poseidon” SHPK eksporton açuge me nivele shumë të larta histamine, Italia i heq nga tregu

më të klikuarat

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni i policisë greke, arrestohen 3 shqiptarë dhe shpallet në kërkim Daniel Dushku

“Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty”/ Deklarata të forta dashurie nga Vlora Hyseni për Ergys Agasin: Të du!

Shkol në GJKKO për tu njohur me masën e sigurisë/ Momenti kur ish-drejtesja e SHISH i kthehet gazetares: Si kalon ti me agentët serbë në hotel (VIDEO)

Dosja e SPAK/ Agasi mori të dhëna në telefonat e “zbërthyer” nga policia! Iu vunë në dispozicion nga përgjegjësi i Sektorit në Policinë Shkencore

insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow.

Bizneset po kërkojnë dhe po marrin me shumë kredi

Ekonomi

25 Shtator 2020, 07:29

Në Shqipëri burrat dominojnë gratë edhe në depozitat bankare

Ekonomi

24 Shtator 2020, 17:00

Kodi Doganor ndryshon, lehtësohen sanksionet për bizneset

Ekonomi

22 Shtator 2020, 08:49

Punësimi sezonal jashtë solli një rekord të ri historik prej gati 400 mln euro në janar-qershor

Ekonomi

22 Shtator 2020, 08:46

Ekonomi

22 Shtator 2020, 08:43

Gati projektligji, kufiri i sigurimit të depozitave rritet në 6 milionë lekë, nga 2.5 aktualisht

TIRANË- Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka përgatitur projektligjin që parashikon rritjen e kufirit ligjor të sigurimit të de...

Hetimet dhe sekuestrimit e SPAK ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!

Ekonomi

22 Shtator 2020, 08:42

Vera 2026 rriti numrin e turistëve, por shtoi pikëpyetjet

Ekonomi

20 Shtator 2026, 07:20

Kartëmonedhat e reja Euro, qytetarët pjesë e vendimarrjes

Ekonomi

19 Shtator 2026, 08:13

Pagesat me kartë rriten, por kartat e kreditit nuk "ndeizin" për shqiptarët

Ekonomi

16 Shtator 2026, 07:17

MË SHUMË



Protesta e 117-ës/ Mbyllet fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit: Rama jep dorëheqjen



Mbyllet fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit...

Aktivisti Lika për Vlora Hysenin: Nuk duhej të futej në SPAK, duhet të jetë në burg

Aktivisti Arben Kola thirrje shqiptarëve në SHBA: Priteni Ramën me vezë para OKB-së...

Aktivistja Vatikaj: Dejtresha e SHISH i jepte informacione Agasit për t'i shpëtuar policisë

Mbyllet fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit...

[Shiko video te tjera](#)



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vërtetë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.